



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 274, datë 01.07.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

RAPORT  
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARES  
{...}  
VITI 2019

---

POLI I DREJTËSISË  
RRUGA “ANA KOMNENA”  
TIRANË

---

## TË DHËNAT E GJYQTARIT

---

**Emri:** {...}

**Mbiemri:** {...} ({...})

**Datëlindja:** 08.11.1984

**Vendbanimi:** Durrës

**Adresa e e-mailit zyrtar:**  [{...} @gjykata.gov.al](mailto: {...} @gjykata.gov.al)

**Adresa e e-mailit privat:** igi {...} @yahoo.com

**Numër telefoni:** 06977733

**Gjykata:** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

**Funksioni:** Gjyqtare

**Seksioni:** Penal

**Vlerësimi i mëparshëm:** Nuk ka

**Masa disiplinore:** Nuk ka

**Periudha e vlerësimit :** 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019

---

## VLERËSUES

---

**Relator :** **Brikena Ukperaj (Lubonja)**

**Nëpunës përgjegjës për vlerësimin :** **Gilda Hoxha**

---

## QËLLIMI

---

*Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij për periudhën e vlerësimit 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare.*

*Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.*

*Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, relatori bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, ashtu sikundër ato përshkruhen dhe detajohen në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.*

---

## PROCEDURA

---

Procedura e vlerësimit të gjyqtarës {...} ka filluar me vendimin nr.314, datë 14.09.2020, “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relator znj. Brikena Ukperaj (Lubonja); Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datë 16.09.2020, në bazë të neneve 85 pika 2 dhe 89 pika 3 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit Janar – Dhjetor 2019 (vlerësimi i përshpejtuar i detyruar), për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të Këshillit brenda afatit 3 ditor.

Më datë 18.09.2020, gjyqtarja {...}, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre ose të çdo anëtari të Këshillit.

Më datë 21.09.2020, nëpërmjet shkresës nr. 4533/1 prot, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar informacion, lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (01.01.2019-31.12.2019). Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kthyer përgjigje, lidhur me informacionin e kërkuar, me

shkresën nr. 2070/1 prot, datë 30.09.2020, protokolluar pranë KLGJ me nr.4533/2, datë 01.10.2020.

Më datë 21.09.2020, nëpërmjet shkresës nr. 4533 prot., Shkollës së Magjistraturës i është kërkuar informacion lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarës {...} në veprimtaritë trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (01.01.2019-31.12.2019). Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e kërkuar me shkresën nr. 752/1 prot., datë 01.10.2020, protokolluar pranë K.L.GJ me nr. 4533/1, datë 02.10.2020.

Në datën 29.09.2020, gjyqtarës dhe kryetarit të gjykatës, i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”. Pas plotësimit, kryetari i gjykatës ka dërguar “Formular i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” në rrugë elektronike si dhe nëpërmjet shkresës protokolluar në KLGJ me shkresën me nr. 5050 prot, datë 12.10.2020. Dy vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja janë dërguar me shkresën me nr.2524 prot., datë 23.04.2021, protokolluar në KLGJ me shkresën me nr.6363/12 prot., datë 27.04.2021.

Pjesë e dosjes së vlerësimit, është bërë edhe kopja e aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private, të dërguar nga I.L.D.K.P.K.I me shkresën me nr. 221/23 prot, datë 21.01.2021, protokolluar në K.L.GJ me nr. 3238/1, datë 22.01.2021.

Me procesverbalin e datës 20.10.2020 nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, bazuar në pikën 10 shkronja “b” të vendimit nr. 197, datë 11.6.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka evidentuar çështjet me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtarja subjekt vlerësimi përtej afateve standarde (afat ligjor ose standard minimal kohor).

Me urdhrin me datë 23.12.2020, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit Janar – Dhjetor 2019, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtarës, kryetarit të gjykatës, si dhe kancelarit të gjykatës më datë 23.12.2020, nëpërmjet postës elektronike.

Bazuar në urdhrin e relatorit, më datë 28.12.2020, në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, dokumentuar në procesverbalin përkatës. Gjyqtarja ka qenë prezent dhe nuk ka shfaqur pretendime në lidhje me procedurën e shortit.

Pas zhvillimit të shortit, me shkresën nr. 147 prot, datë 14.01.2021, protokolluar në KLGJ me nr. 6363/1 prot, datë 15.01.2021, janë dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier 4 (katër) dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short. Me shkresën me nr.233 prot., datë 19.03.2021, protokolluar në KLGJ me nr. 6363/1 prot, datë 15.01.2021 është dërguar 1(një) dosje nga Gjykata e Apelit Vlorë<sup>1</sup> dhe dosja e fundit është dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

---

<sup>1</sup> Në këtë shkresë është sqaruar se një prej çështjeve të përzgjedhura me short ndodhet në gjykatën e Lartë. Pas njoftimit nëpërmjet postës elektronike të Gjykatës së Lartë për dërgimin e kësaj dosje rezultoi se me shkresën me nr.1093/1 prot., datë 09.04.2021 është sqaruar se çështja me nr.409 regj. Them, datë regjistrimi 15.07.2019, nr.351 vendimi, datë 16.10.2019 ndodhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

me shkresën me nr.2072 prot., datë 08.04.2021, protokolluar në KLGJ me shkresën me nr.1499/1 prot., datë 12.04.2021.

Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim<sup>2</sup>, ka filluar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, hartimi i raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...} {...}.

Më datën 04.05.2021, nga ana e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimi znj. Gilda Hoxha, është dorëzuar i përfunduar “Raporti analitik për vlerësimin etik dhe profesional”.

Me vendimin “Për plotësinë e procedurës dhe dokumentacionit të dosjes së vlerësimit për gjyqtaren {...}, periudha e vlerësimit viti 2019”, në datën 08.06.2021, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vendosur: *“Vlerësimin e plotësisë së dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura në krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik për gjyqtaren {...} {...}. Vijimin e procedurës së vlerësimit për hartimin e projektraportit të vlerësimit...”*

Projektraporti i vlerësimit i përgatitur nga relatori, iu njoftua gjyqtarës në adresën e saj elektronike. Në dt. 16.06.2021, brenda afatit 1/javor, gjyqtarja konfirmoi marrjen dijeni si dhe parashtrori se nuk kishte kundërshtime apo prova të reja për të paraqitur. Gjyqtarja shprehu vullnetin për të mos u dëgjuar në seancë dëgjimore.

Projektraporti i vlerësimit u shqyrtua nga Këshilli në Mbledhjen Penale të dt. 01.07.2021 dhe u miratua prej tij në tërësi pa ndryshime.

---

<sup>2</sup> Dokumenti i fundit i administruar në dosjen e vlerësimit të gjyqtarës {...} {...} janë dy vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, të cilat janë dërguar me shkresën me nr.2524 prot., datë 23.04.2021, protokolluar në KLGJ me shkresën me nr.6363/12 prot., datë 27.04.2021.

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A Njohuritë ligjore.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën ligjore relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

*- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*

Gjyqtarja, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi përcaktimit të detajuar të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsytimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në vendimet e themelit dhe ato me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal”, gjyqtarja, në pjesën e parë të arsytimit të titulluar “rrethanat e çështjes” apo “faktet dhe provat”, përshkruan fillimisht kronologjinë e ngjarjes mbi të cilën mbështetet fakti penal si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri apo të pandehurit, duke i integruar provat me faktet e çështjes. Elementë të faktit penal bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale në pjesën e titulluar “arsyetime ligjor”, duke i kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet analiza e provave dhe kualifikimi ligjor.

Në vendimet penale të analizuara, nëpërmjet të cilave është vendosur deklarimi fajtor<sup>3</sup> dhe dënimi i të pandehurit, gjyqtarja evidenton dhe analizon edhe faktet të cilat ndikojnë në individualizimin e dënimit.

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. 2519(205), datë 09.05.2019, vendimi nr.5154(351), datë 16.10.2019 si dhe vendim nr.4138(286), datë 24.07.2019.

Në çështjen e seancës paraprahe me objekt “*dërgimin e çështjes në gjyq*”<sup>4</sup>, gjyqtarja arsyetimin e vendimit e fillon me përshkrimin e rrethanave procedurale të çështjes dhe më pas vijon me pasqyrimin e fakteve, të cilat kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit.

Në çështjen me objekt “*pushimin e procedimit penal*”<sup>5</sup>, faktet e çështjes janë evidentuar në mënyrë përshkruese në nënndarjen e dytë të pjesës përshkruese-arsyetuese të titulluar “*rrethanat e faktit*”, duke renditur në mënyrë kronologjike veprimet hetimore të kryera nga prokuroria në funksion të provueshmërisë së faktit penal të pretenduar. Në vendimin nr. 5626 (907) elementët e faktit penal gjenden edhe në pjesën e titulluar “*vlerësimi i gjykatës*”, të integruara dhe me provat e administruara në gjykim.

Në vendimin me nr.3149(860), datë 10.06.2019 me objekt “*ulje dënimi*”, gjyqtarja përshkruan rrethanat procedurale të çështjes duke evidentuar kërkesën e paraqitur gjykatës, caktimin e seancës gjyqësore nga gjykata për shqyrtimin e kësaj kërkesë si dhe vullnetin e palës kërkuese për tu tërhequr nga gjykimi. Nuk përshkruan faktet e çështjes, nisur nga natyra e vendimit, me të cilin është disponuar për deklarimin si të papranueshme të kërkesës penale;

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, referuar kategorisë së çështjes, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit (*gjykim themeli, kërkesë për dërgim në gjyq, pushimin e procedimit penal ose kërkesë me objekt uljen e dënimit*), duke u evidentuar në disa raste në mënyrë të shprehur, si një element që orienton gjykatën në evidentimin e juridiksionit, kompetencës, detyrimit të gjykatës për njoftimin e kërkesës subjekteve procedurale (*të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës dhe trashëgimtarëve kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim*), analizën ligjore të çështjes, sipas natyrës së saj... etj.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon qartë ligjin e zbatueshëm, citon dhe analizon dispozita të ligjit material ose procedural, në shërbim të analizës ligjore të tyre dhe ndërthurjes me elementet procedurale apo faktet e çështjes mbi të cilat zbatohen këto dispozita.

***Sa i përket ligjit procedural penal***, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm dhe analizon kur është rasti:

- (i) nenin 69, 74 dhe 76/1 të K.Pr.Penale, lidhur me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes<sup>6</sup>. Gjithashtu, në disa raste referuar sanksionit të veprës

<sup>4</sup> Vendim nr.4743(795), datë 25.09.20019.

<sup>5</sup> Vendim nr.4427(738), datë 11.09.2019 dhe vendim nr.5626(907), datë 05.11.2019.

<sup>6</sup> Vendim nr.2519(205), datë 09.05.2019, vendim nr. 351 datë 16.10.2019 dhe vendim nr.4743(795), datë 25.09.20019, vendim nr.4138(286), datë 24.07.2019.



- penale, gjykata pasqyron gjykimin e çështjes me 1 apo 3 gjyqtar, duke cituar nenin 13/3 të K.Pr.Penale;
- (ii) nenet 375 dhe 152 të K.Pr.Penale, mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe çmuarjen e provës<sup>7</sup>;
- (iii) nenet 278, 291 të K.Pr.Penale<sup>8</sup>, lidhur me kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në hetimet paraprake dhe të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal;
- (iv) nenet 331/2, 327/2/3/4, 332/ë/1 dhe 128/a të K.Pr.Penale, lidhur me elementët e domosdoshëm të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, përmbajtjen e fashikullit të gjykimit si dhe disponimin e prokurorit në fund të hetimeve paraprake, në funksion të mënyrës së zgjidhjes së çështjes<sup>9</sup>;
- (v) nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar<sup>10</sup>;
- (vi) nenet 291 dhe 329, 329/a të K.Pr.Penale, lidhur me kontrollin gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal në rastin e kundërvajtjeve penale, disponimin e prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake kur hetohet për krime si dhe kërkesën për pushimin e çështjes<sup>11</sup>;
- (vii) nenin 471/5 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e procedimit nga gjykata në rastet e shqyrtimit të kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve<sup>12</sup>;

**Sa i përket ligjit material të zbatueshëm**, në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja identifikon saktë dispozitat materiale penale, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenet e Kodit Penal mbi të cilat bëhet kualifikimi ligjor i faktit/fakteve penale për të cilat procedohet, apo për të cilat akuzohen të pandehurit në çdo çështje dhe konkretisht:

- (i) nenin 143 të K.Penal, lidhur me veprën penale të “mashtimit”<sup>13</sup>;
- (ii) nenin 297 të K.Penal, në lidhje me veprën penale të “kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror”<sup>14</sup>;
- (iii) neni 161 i Kodit Penal, lidhur me elementët e figurës së veprës penale “shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”<sup>15</sup>;
- (iv) nenin 283/2 të K.Penal, lidhur me veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”<sup>16</sup>;
- (v) nenet 186 dhe 189/1 të K.Penal, lidhur me veprat penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe “falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”<sup>17</sup>;
- (vi) nenin 130/a/1 të Kodit Penal, lidhur me elementët e figurës së veprës penale “dhunës në familje”, duke referuar për këtë qëllim dhe në ligjin nr.47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në familje”

<sup>7</sup> Vendim nr.2519(205), datë 09.05.2019

<sup>8</sup> Vendim nr.2867(780), datë 27.05.2019.

<sup>9</sup> Vendim nr.4743(795), datë 25.09.2019.

<sup>10</sup> Vendimi nr.4743(795), datë 25.09.2019.

<sup>11</sup> Vendim nr.4427(738), datë 11.09.2019 dhe vendim nr.5626(907), datë 05.11.2019.

<sup>12</sup> Vendim nr.3149(860), datë 10.06.2019.

<sup>13</sup> Vendim nr.2519(205), datë 09.05.2019.

<sup>14</sup> Vendimi nr.4743(795), datë 25.09.2019.

<sup>15</sup> Vendim nr.4427(738), datë 11.09.2019.

<sup>16</sup> Vendim nr.5154(351), datë 16.10.2019.

<sup>17</sup> Vendim nr.4138(286), datë 24.07.2019.

Gjithashtu, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, si:

- (i) kriteret ligjore të individualizimit të dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke referuar parashikimet e nenit 47, 48, 49 të Kodit Penal të cilat janë referuar dhe analizuar në vendimet penale të deklarimit fajtor dhe dënimit të të pandehurit<sup>18</sup>;
- (ii) nenin 50 lidhur me kuptimin e recidivizmit si rrethanë rënduese;
- (iii)nenin 59 lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim;
- (iv)nenin 1/b të K.Penal lidhur me detyrat e legjislacionit penal;

Në disa raste, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës së R.Sh. për të dhënë kuptimin e dispozitave të ligjit procedural, si më poshtë:

- (i) nenin 42 dhe 148 të Kushtetutës, lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe të drejtën për të kundërshtuar veprimet e prokurorit pranë një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm<sup>19</sup>;

Në disa raste, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe ligje të tjera të posaçme, të cilat gjejnë zbatim në çështjet konkrete, lidhur me aspekte materiale apo procedurale, si më poshtë:

- (i) ligjin nr.47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në familje”<sup>20</sup>;
- (ii) ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat e dhe trajnimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”<sup>21</sup>;

***Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave***, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Në çështjet komplekse<sup>22</sup>, faktet përshkruhen më vete për çdo episod, në mënyrë kronologjike dhe lehtësisht të perceptueshme. Ajo ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtarja i objektit të gjykimit, duke u fokusuar vetëm në të, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes, analizë e cila është e ndryshme në bazë të kërkesës mbi të cilën gjykata është investuar.

<sup>18</sup>Vendimi nr.2867 (780), datë 27.05.2019 dhe vendim nr.5154(351), datë 16.10.2019 dhe nr.4138(286), datë 24.07.2019.

<sup>19</sup> Vendim nr.2867(780), datë 27.05.2019 dhe vendim nr.4427(738), datë 11.09.2019.

<sup>20</sup>Vendimi nr.5626(907), datë 05.11.2019.

<sup>21</sup> Vendim nr.3149(860), datë 10.06.2019.

<sup>22</sup> Vendim nr.2519(205), datë 09.05.2019

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

#### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Normat ligjore procedurale dhe materiale, identifikohen, interpretohen dhe aplikohen mbi faktin, në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtarja në lidhje me zbatimin e tyre. Vetëm në disa raste ku objekti i shqyrtimit është i kufizuar nga lloji i kërkesës (kërkesë në fazën e ekzekutimit të vendimeve), normat procedurale, referohen drejtpërdrejt, pa u bërë më parë një interpretim i pavarur i dispozitës<sup>23</sup>. Mungesa e interpretimit abstrakt në këtë rast kushtëzohet nga objekt i gjykimit dhe vlerësimi të gjykatës në këto raste, i cili ka karakter procedural.

#### ***-Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale:***

Gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi interpretimit të normës, në drejtim të zgjidhjes së situatave procedurale, të iniciuara nga palët (*kërkesat e palëve*), iniciuara kryesisht ose si domosdoshmëri e procesit të të provuarit.

#### ***Konkretisht gjyqtarja interpreton:***

- (i)* nenet 403 dhe 405/5 dhe 6 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar sa i përket plotësimin e kushteve ligjore të këtij neni,<sup>24</sup>; Në lidhje me këtë institut gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- (ii)* nenet 375 dhe 152 të K.Pr.Penale lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe çmuarjen e provave;
- (iii)* nenet 278, 291 të K.Pr.Penale lidhur me kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në hetimet paraprake dhe të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal;
- (iv)* nenet 331/2, 327/2/3/4, 332/ë/1 dhe 128/a të K.Pr.Penale, lidhur me elementët formalë që përmban kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, pasojat juridike të pavlefshmërisë së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në rastin e mosrespektimit të këtyre kritereve formale, si dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit, në funksion të mënyrës së zgjidhjes së çështjes;

#### ***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së fakti penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të K. Penal, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Në këto çështje gjyqtarja ndalet në interpretimin e neneve përkatëse të Kodit Penal, posaçërisht në lidhje me *(i)* formën e

<sup>23</sup> Shih vendimin nr.3149(860), datë 10.06.2019

<sup>24</sup>Vendimi nr.2519(205), datë 09.05.2019, vendim nr.5154(351), datë 16.10.2019, .

kryerjes së veprës penale, (ii) qëllimin kur ai përbën element të domosdoshëm për ekzistencën figurës së veprës penale, (iii) rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale në bashkëpunim, më shumë se një herë, në dëm të disa personave si dhe rrethanën cilësuese të pasojës së rëndë (iv) rrethanat apo motivet që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale kur ato janë thelbësore për të provuar anën subjektive të veprës penale, .. etj.

**Dispozitat e Kodit Penal (të pjesës së posaçme)** analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale në çështjet e themelit dhe pjesërisht dhe për aq sa është e nevojshme në çështjet e seancës paraprake. Në këto të fundit, gjyqtarja përqendrohet më tepër në elementë të anës objektive të veprave penale, duke i analizuar në disa raste, në raporte krahasimore me njëra tjetrën, me qëllim cilësimin e saktë juridik të faktit penal. *Konkretisht :*

- (i) Në vendimin nr.2519(205), datë 09.05.2019 gjyqtarja interpreton në mënyrë literale dispozitën materiale (nenin 143 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit. Po në këtë vendim gjyqtarja duke evidentuar faktin që veprimtaria kriminale e të pandehurve shtrihet në periudha të ndryshme kohore (duke filluar nga viti 2015 deri në momentin e arrestimit të tyre), në funksion të identifikimit të ligjit material të zbatueshëm, ka interpretuar nenin 143 të K.Penal para dhe pas ndryshimeve që ka pësuar kjo dispozitë me ligjin nr.36/2017, datë 30.03.2017;
- (ii) Në vendimin nr. 738 datë 11.09.2019 gjyqtarja interpreton dispozitën materiale të “Shkatërrimit të pronës nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 të Kodit Penal duke interpretuar elementët domosdoshëm të saj;
- (iii) Në vendimin nr.351, datë vendimi 16.10.2019 gjyqtarja interpreton nenin 283/2 të K.Penal në lidhje kualifikimin juridik të faktit penal atribuar të pandehurit mbështetur në rrethanat e faktit dhe provat përkatëse. Interpretimin e dispozitës materiale gjykata nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e kësaj figure veprë penale, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Referuar provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe të analizuar në tërësinë e tyre, gjykata konkludon në cilësimin juridik të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të autorit për veprën penale që atij i atribuohet;
- (iv) Në vendimin nr.286, datë 24.07.2019 interpreton në mënyrë literale dispozitat materiale (nenet 186/1 dhe 189/1 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprave penale për të cilat akuzohet i pandehuri. Interpretimin e normave relevante gjykata nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e veprave penale, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Referuar provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe të analizuar në tërësinë e tyre, gjykata konkludon në cilësimin juridik të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të autorit për veprat penale që atij i atribuohet (duke i analizuar veprat në mënyrë të mëvetësishme).
- (v) Në vendimin nr.907, datë 05.11.2019 interpreton dispozitën materiale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a pg.1 të Kodit Penal duke interpretuar elementët domosdoshëm të saj;

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe *interpretimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal* në lidhje me:

- (i) rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale në bashkëpunim, më shumë se një herë, në dëm të disa personave si dhe rrethanën cilësuese të pasojës së rëndë etj;
- (ii) qëllimin e dënimit penal, si dhe aplikimin e rrethanave që ndikojnë në individualizimin e dënimit për të pandehurin si dhe duke u ndalur në një rast në analizimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit, duke interpretuar nenin 59 të K.Penal si formë alternative të vuajtjes së dënimit. Analiza e dispozitës nuk mbetet vetëm në nivel teorik, por përforcohet me qëllim zbatimi, edhe me analizën e rrethanave konkrete që përlligjin zbatimin e saj;

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, rezulton se gjyqtarja ka respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtat e palëve, duke iu krijuar atyre mundësi të marrin pjesë në gjykim, të dëgjohen, të kërkojnë marrjen e provave, të debatojnë mbi provat, të kenë asistencën e mbrojtësit, etj. Në një vendim, gjyqtarja në funksion të konkluzionit për fajësinë e të pandehurve referon në *parimin e drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit*, parim i sanksionuar në nenin 1/c të K.Penal. Gjithashtu gjyqtarja referon në *parimin e ligjshmërisë* së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të si dhe në parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt penal (*ne bis in idem*). Gjyqtarja për të evidentuar rolin e gjykatës në kontrollin e veprimeve të prokurorit referon në *parimin e ligjshmërisë* duke evidentuar se e drejta për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore është në përputhje me standardet e vendosura në nenin 42 të Kushtetutës;

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante:***

Gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin e ligjit dhe aplikimin e tij mbi faktet, posaçërisht në lidhje me:

- (i) aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar, duke referuar Vendimit Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke evidentuar se ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to;
- (ii) interpretimin e nenit 143 të K.Penal dhe evidentimin e mbrojtjes së posaçme juridike të marrëdhënieve të vendosura për të siguruar të drejtën e pronësisë publike apo private të personit juridik shtetëror apo privat si dhe të drejtat pasurore, paprekshmërinë e tyre nga veprimet apo mosveprimet kriminale, ku referimi bëhet në Vendimin nr.354, datë 20.12.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu gjyqtarja {...} referon vendimin e lartpërmendur edhe për të dhënë konceptin juridik të mashtrimit, ndërsa për të bërë dallimin midis krimit të mashtrimit nga krimet e tjera kundër pasurisë si dhe nga marrëdhëniet juridike civile, referon dhe në Vendimin nr.100, datë 13.07.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- (iii) për të dhënë kuptimin e rrethanës cilësuese “*pasojë e rëndë*” gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues Nr.5, datë 11.11.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- (iv) në lidhje me mënyrën e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga prokurori si dhe shqyrtimin e ankimit ndaj këtij vendimi nga gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues nr.2, datë 20.06.2013.

## **KONKLUSIONE:**

*Në tërësi*, në vendimet përfundimtare, interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës abstrakte të kuptimit të tyre sipas ligjit të kohës, para aplikimit mbi faktet konkrete, pasurohet me referimin në praktikën unifikuese/njehsuese të Gjykatës së Lartë, praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës. Interpretimi i normave materiale ose procedurale, para aplikimit mbi faktet e çështjes apo situatat procedurale konkrete, është konciz për atë sa çështja e lejon dhe zë të njëjtën peshë si në vendimet e themelit ashtu dhe në vendimet e tjera që lidhen me disponime të gjykatës për kërkesa të fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake apo atyre në fazën e ekzekutimit të vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### **1.B Arsyetimi ligjor**

#### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues*, rezulton se, gjuha e përdorur nga gjyqtarja në komunikimin me palët gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuarra dhe vendimet përfundimtare, është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë për palët në proces, si dhe për lexuesin e akteve. Gjyqtarja përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte. Referimi i parimeve të së drejtës në gjuhën latine, është shoqëruar me dhënien e kuptimit të tyre në gjuhën shqipe, duke mos krijuar paqartësi lidhur me kuptimin dhe zbatimin e tyre. Gjyqtarja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës si dhe paragrafë të strukturuar, të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin duke treguar vijueshmëri të arsyetimit.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, tregon qartësinë dhe vijueshmërinë e mendimit duke i bërë vendimet të kuptueshme.

## KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila përmbledh përmbajtjen e tij dhe shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por siguron qëndrueshmëri të mendimit, pa ndërprerje të tij dhe e bën mendimin të rrjedhë natyrshëm, si një i tërë. Evidentohet shkallë e lartë aftësie e gjyqtarës në drejtim të koncizitetit të fakteve përshkruese, provave të analizuara, analizës ligjore dhe argumentimit logjik.

### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Vendimet përfundimtare të gjyqtarës, referuar kategorisë së çështjes dhe kompleksitetit të përmbajtjes së vendimit, ndjekin përgjithësisht strukturë të njëjtë brenda së njëjtës kategori. Të gjitha vendimet përmbajnë elementët e domosdoshëm të vendimit gjyqësor penal sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P dhe 332/dh të K.Pr.P, në rastet e disponimit për dërgimin e çështjes në gjyq, duke përmbajtur pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit. Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të të pandehurve dhe viktimave, përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal ose Kodit të Procedurës Penale, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkruese- arsyetuese e vendimeve ndjek një strukturë të mirë përcaktuar e cila është e dukshme edhe në aspektin vizual, ku secila pjesë titullohet në përputhje me përmbajtjen e saj. Organizimi i pjesëve të arsyetimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke pasur ndryshime të saj vetëm për shkak të objektit të çështjes. Në vendimet e themelit<sup>25</sup>, pjesa përshkruese arsyetuese fillon me paraqitjen e rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes në rend kronologjik.

Më pas arsyetimi vijon me pjesën e titulluar “arsyetimi ligjor” në të cilën gjyqtarja shtjellon analizën e ligjit të zbatueshëm, interpretimin e tij dhe zbatimin mbi faktet e çështjes për të arritur tek konkluzionet e gjykatës lidhur me çdo element të analizuar. Në këtë pjesë të arsyetimit referimi dhe interpretimi i ligjit procedural dhe material të zbatueshëm, integrohet me faktet respektive të provuara në gjykim si dhe me konkluzionet e arritura nga gjyqtarja në arsyetim, lidhur me çështjet e shqyrtuara. Po në këtë pjesë të arsyetimit, në fund të saj,

<sup>25</sup> Vendimi nr.2519 (205), datë 09.05.2019, vendim nr.5145(351), datë 16.10.2019 dhe vendim nr.4138(286), datë 24.07.2019.

gjqtarja merr në analizë rrethanat e individualizimit të dënimit, duke i analizuar në mënyrë të detajuar secilën prej tyre. Në pjesën e fundit të arsytimit, përcaktohen modalitetet e përlogaritjes së vuajtjes së dënimit, vlerësimin dhe disponimin lidhur me provat materiale dhe disponimin për shpenzimet gjyqësore.

Të njëjtën strukturë kanë dhe vendimet me objekt ankim kundër vendimit prokurorit për mosfillimin e procedimit penal apo me objekt pushimin e procedimit penal.

Në vendimin me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, pjesa arsyetuese nuk është e strukturuar formalisht me disa nënndarje, por në përmbajtje të kësaj pjese rezulton se gjyqtarja analizon faktet e çështjes të integruara me provat, dispozitat ligjore konkrete që gjejnë zbatim në çështjen konkrete si dhe analizën ligjore të legjislacionit të zbatueshëm, të aplikuar mbi faktet e çështjes.

Në të gjitha vendimet, përmbajtja e vendimit është e ndarë në paragrafë, të cilat përmbajnë edhe numërtim dhe lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri të arsytimit.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur, në vendimet e themelit, të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve, uljen e dënimit për shkak të gjykimin të shkurtuar kur është rasti, kohën e fillimit të llogaritjes së dënimit, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe të drejtën e ankimit.

Në vendimet e tjera, pjesa urdhëruese e vendimit përbën disponimet për prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, urdhërimin e prokurorisë për të regjistruar procedimin dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit, pushimin e procedimit penal, deklarimin e papranueshme të kërkesës për shkak të heqjes dorë, disponimet për dërgimin e çështjes në gjyq në përputhje me nenin 332/e të K.Pr.P<sup>26</sup>. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet lidhur me të gjithë elementët e vendimit përfundimtar.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

<sup>26</sup> Vendimi nr. 115, datë 11.11.2019, vendimi nr. 75, datë 17.06.2019 dhe vendimi nr. 5+6, datë 23.04.2019.



### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në të gjitha dokumentet ligjorë të analizuar, rezulton se arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve në proces.

Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.:

- Analizon sipas doktrinës juridike konceptin e “*mashtrimit*”, dallimin e krimit të mashtrimit me krime të tjera kundër pasurisë dhe marrëdhëniet juridike civile. Gjithashtu analizon institutin e “*bashkëpunimit*” si dhe jep kuptimin “*pasojë e rëndë*” dhe “*më shumë se një herë*” nën këndvështrimin e rrethanave cilësuese; Analizon nën këndvështrimin juridik konceptin e gënjeshtërisë, lajthitjes, shpërdorimit të besimit etj.;
- Analizon konceptin e *ndjekjes penale* duke interpretuar nenin 148/1 të Kushtetutës duke arsyetuar se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit duke argumentuar se ky detyrim rrjedh nga fakti se ai është garant i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kritereve të përcaktuara;
- Analizon të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në përputhje me *parimin e ligjshmërisë* së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të;

Në vendimet e analizuara, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi dhe kujdes të posaçëm analizës së plotë dhe të qartë të faktit penal së bashku me përshkrimin e ecurisë procedurale të çështjes dhe hapat që ka ndjekur procedimi penal. Paraqitja dhe analiza e plotë dhe logjike e provave, duke i integruar ato me analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe në raport me elementet e faktit penal, i jep arsyetimit qartësi dhe zhvillim logjik.

Gjyqtarja integron në mënyrë logjike dhe në vendin e duhur dispozitat ligjore të zbatueshme, të cilat kryesisht pas citimit ose referimit të tyre, shoqërohen me interpretim dhe më pas me zbatim mbi faktet e çështjes, duke pasuruar argumentimin logjik me qëndrimet e praktikës gjyqësore.

Në secilin vendim penal të analizuar, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të çështjes (*gjykim themeli, kërkesë e fazës së hetimit paraparak ose kërkesë e seancës paraprate*), analiza dhe arsyetimi shtjellohen në mënyrë logjike. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit ligjor të gjykatës ku ai integrohet me analizën ligjore, e bën atë një analizë të plotë, të gjithanshme dhe të kuptueshme për lexuesin. Në vendimet e themelit gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë

analizës së integruar të provave në raport me katër elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, që lidhen me elementë të veçantë të anës objektive dhe subjektive të veprës, si: kryerja e veprimeve aktive të kundraligjshme me anë të gënjeshtërs, lajthitjes, shpërdorimit të besimit<sup>27</sup>, kryerja e veprës penale në bashkëpunim ose më shumë se një herë<sup>28</sup>, ardhjen e pasojave të rënda<sup>29</sup>

Në cilësinë e analizës, veçanërisht në çështjet e themelit dhe ato me objekt pushimin e procedimit penal, spikat lidhja në mënyrë të drejtpërdrejtë e faktit/fakteve të provuara, me elementët e figurës së veprës penale, të analizuara më parë në arsyetim, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë dhe konkluzionin e arritur për provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale. Mënyra e organizimit të arsytimit ligjor, që ndjek kryesisht rregullin : referim ose citim i ligjit; interpretim abstrakt i tij; zbatim i ligjit mbi faktin konkret dhe konkluzioni i gjykatës, bën që të evidentohet qartë lidhja shkak- pasojë. Konkluzionet vijnë si rezultat i zhvillimit logjik të koncepteve ligjore, pavarësisht zgjidhjes së çështjes.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në vendimet penale të analizuara, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në pjesën përshkruese –arsyetuese të vendimit. Analiza e kërtimeve dhe pretendimeve të palëve, me karakter procedural apo material, merr gjithmonë përgjigje të argumentuar në arsyetimin e vendimit, në drejtim të mbështetjes në ligj ose prova të tyre.*

## **KONKLUZIONE:**

*Në tërësi, në vendimet gjyqësore të analizuara, analiza ligjore si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjykimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Cilësia e analizës dhe argumentimin logjik përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet me interpretim të pavarur të ligjit si dhe qëndrime të praktikës gjyqësore, të cilat integrohen në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsyetim.*

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “ shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit

<sup>27</sup> Vendim nr.2519(205\_, datë 09.05.2019

<sup>28</sup> Vendim nr.5154(351), datë 16.10.2019

<sup>29</sup> Vendim nr.2519(205\_, datë 09.05.2019 dhe Vendim nr.5154(351), datë 16.10.2019

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 168 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin dy kategorive, “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” dhe “çështje penale të seancës paraprake”.

Nga këto 150 çështje kanë përfunduar brenda afatit ligjor dhe 18 prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit.

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (18 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (168 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 10.71 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se referuar statistikave, rezulton se, gjykimi i çështjeve pothuajse ka përfunduar brenda afateve ligjore të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, me përjashtim të një numri shumë të vogël që ka tejkaluar këto afate, për shkaqe objektive që lidhen me procedurat e njoftimit të palëve, si dhe për shkak të identifikimit të viktimave për herë të parë në gjykim dhe njoftimin e tyre. Konkretisht, gjyqtarja ka deklaruar se kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake që lidhen me vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit, janë gjykuar brenda afatit prej 48 orësh. Kërkesat për lejimin e kontrollit, lejimin ose vleftësimin e përgjimit janë shqyrtuar brenda 24 orëve. Ankimet ndaj vendimit të mosfillimit janë shqyrtuar brenda afatit 30 ditor, me përjashtim të një rasti kur ky afat ka kaluar disa ditë për shkak të procedurës së njoftimit të palës ankuese. Kërkesat për dërgimin në gjyq janë shqyrtuar brenda afatit 30 ditor, me përjashtim të disa rasteve që kanë tejkaluar këtë afat për shkak të vështirësive të hasura gjatë gjykimit në procedurat e njoftimit të pandehurit apo për shkak të faktit se nga ana e prokurorit nuk është identifikuar viktimë e veprës penale. Për shkak se identifikimi i viktimës dhe legjitimitimi i saj si palë pjesëmarrëse në proces është bërë për herë të parë në gjykim, është hasur vështirësi në njoftimin e saj.

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit.

Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, për 18 çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor, rezulton se:

**Në tabelën nr. 10**, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*” rezulton që çështjet e shqyrtuara jashtë afat ligjor janë çështjet me objekt *zëvendësim mase sigurimi ose kundërshtim të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, të cilat janë shqyrtuar jashtë afatit 5 ditor apo 30 ditor të parashikuar përkatësisht në nenet 260 pika 4 dhe 291 pika 3 e K.Pr.Penale*)<sup>30</sup>.

Duke iu referuar kësaj kategorie çështjesh rezulton se çështja me numër rendor 48, me nr.1314 regj., është regjistruar në datë 23.07.2019 dhe ka përfunduar me nr.1318 vendimi, datë 18.09.2019. Duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes në gjykatë (23.07.2019) dhe datës së vendimit (18.09.2019), rezulton se çështja, duke përfshirë në kohëzgjatjen e saj edhe muajin Gusht në të cilin gjyqtarët marrin pushimet vjetore, shkak i cili duket se ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështje gjykimi ka zgjatur **1 muaj e 25 ditë**. Nëse kjo periudhë nuk do të përfshinte muajin Gusht, atëherë gjykimi mund të kishte përfunduar për 25 ditë, brenda afatit ligjor (30 ditor). Ndërsa çështjet me numër rendor 59 dhe 70 me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit kanë zgjatur përkatësisht për 1 muaj e 3 ditë dhe 1 muaj e 1 ditë, çka do të thotë se tejkalimi i afatit 30 ditor është bërë me 3 dite dhe 1 ditë, tejkalim i papërfillshëm në raport me afatin ligjor.

**Në tabelën nr. 11** të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 96 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor, nga të cilat 13 çështje janë gjykuar jashtë këtij afati<sup>31</sup> dhe 83 çështje janë gjykuar brenda këtij afati. Në

---

<sup>30</sup> Çështja me nr. rendor 35, me nr.1102 regj., datë 18.06.2019, me nr. 995 vendimi, 02.07.2019 me objekt “zëvendësimin e masës së sigurimit” është gjykuar për **14 ditë**. Çështja me nr. rendor 38, me nr.1173 regj., datë 02.07.2019, me nr. 1085 vendimi, 16.07.2019 me objekt “zëvendësimin e masës së sigurimit” është gjykuar për **14 ditë**.

Çështja me nr. rendor 48, me nr.1314 regj., datë 23.07.2019, me nr. 1318 vendimi,18.09.2019 me objekt “ankim ndaj vendimit të mosfillimit” është gjykuar për **1 muaj e 25 ditë**. Çështja me nr. rendor 59, me nr.1820, datë 31.10.2019, me nr. 1827 vendimi,03.12.2019 me objekt “ankim ndaj vendimit të mosfillimit” është gjykuar për **1 muaj e 3 ditë**. Çështja me nr. rendor 70, me nr.1950, datë 22.11.2019, me nr. vendimi, datë 23.12.2019 me objekt “ankim ndaj vendimit të mosfillimit” është gjykuar për **1 muaj e 1 ditë**.

<sup>31</sup> Në tabelën nr. 11, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seanca paraprake*” rezulton që çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor janë të gjitha me objekt “*dërgim në gjyq*” dhe më konkretisht janë çështjet me nr,rendor 22, 32, 63, 79, 87, 95, 109, 144, 157, 158, 159, 193 dhe 201. Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se çështja me nr.rendor 22 me nr.181/1089 regj., datë 11.12.2018, me nr.107 vendimi, datë 24.01.2019 ka përfunduar për **1 e muaj 12 ditë**. Çështja me nr.rendor 32, me nr.182/1113 regj., datë 11.12.2019, me nr.160 vendimi, datë 05.02.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 23 ditë**. Çështja me nr.rendor 63, me nr.360 regj., datë 12.02.2019, me nr.370 vendimi, datë 28.03.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 15 ditë**. Çështja me nr.rendor 79, me nr.675/184 regj., datë 16.07.2019, me nr.469 vendimi, datë 02.05.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 16 ditë**. Çështja me nr.rendor 87, me nr.535 regj., datë 16.04.2019, me nr.507 vendimi, datë 20.05.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 3 ditë**. Çështja me nr.rendor 95, me nr.483 regj., datë 15.03.2019, me nr.549 vendimi, datë 05.06.2019 ka përfunduar për **2 muaj e 20 ditë**. Çështja me nr.rendor 109, me nr.593 regj., datë 08.05.2019, me nr.613 vendimi, datë 01.07.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 21 ditë**. Çështja me nr.rendor 144, me nr.851 regj., datë 26.07.2019, me nr.744 vendimi, datë 13.09.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 16 ditë**. Çështja me nr.rendor 157, me nr.739 regj., datë 03.07.2019, me nr.802 vendimi, datë 26.09.2019 ka përfunduar për **2 muaj e 23 ditë**. Çështja me nr.rendor 158, me nr.729 regj., datë 26.06.2019, me

këto 13 çështje rezultojn se afati është tejkaluar nga **4 ditë deri në 1 muaj e 28 ditë**. Duke iu referuar kësaj kategorie çështjesh rezultojn se çështja me numër rendor 144, me nr.851 regj., është regjistruar në datë 26.07.2019 dhe ka përfunduar me nr.744 vendimi, datë 12.09.2019. Duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes në gjykatë (26.07.2019) dhe datës së vendimit (12.09.2019), rezultojn se çështja, duke përfshirë në kohëzgjatjen e saj edhe muajin Gusht në të cilin gjyqtarët marrin pushimet vjetore, shkak i cili duket se ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështje gjykimi ka zgjatur **1 muaj e 16 ditë**. Nëse kjo periudhë nuk do të përfshinte muajin Gusht, atëherë gjykimi mund të kishte përfunduar për 16 ditë, brenda afatit ligjor. Për këtë arsye, vlerësohet se kohëzgjatja e kësaj çështje, duke qenë se nuk lidhet me shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës, do të vlerësohet si e përfunduar brenda afatit ligjor. I njëjti arsyetim vlen edhe për çështjen me numër rendor 159, me nr.855 regj., datë 29.07.2019, me nr.795 vendimi, datë 25.09.2019, e cila ka përfunduar për **1 muaj e 26 ditë (përfshirë edhe periudhën e muajit gusht)**, çka do të thotë se nëse kjo periudhë nuk do të përfshinte muajin Gusht, atëherë gjykimi mund të kishte përfunduar për 26 ditë, brenda afatit ligjor.

*Sa më sipër*, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës së më sipër, rezultojn të jetë 13 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (13 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (168 çështje), gjyqtarja rezultojn që të ketë gjykuar 7.73 % të çështjeve tej afatit ligjor.

## **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pas analizës logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojn të jetë 7.73 %, e cila përkon më nivelin maksimal të pikëzimit për këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarës, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.*

---

nr.803 vendimi, datë 26.09.2019 ka përfunduar për **2 muaj e 28 ditë**. Çështja me nr.rendor 159, me nr.855 regj., datë 29.07.2019, me nr.795 vendimi, datë 25.09.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 26 ditë**. Çështja me nr.rendor 193, me nr.1000 regj., datë 24.10.2019, me nr.991 vendimi, datë 03.12.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 4 ditë**. Çështja me nr.rendor 201, me nr.1047 regj., datë 07.11.2019, me nr.1043 vendimi, datë 18.12.2019 ka përfunduar për **1 muaj e 11ditë**.

## **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, duke iu referuar standardit minimal për çdo kategori çështjes, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010<sup>32</sup> të KLD-së, rezultojnë se gjyqtarja ka gjykuar në total 445 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas kategorive, çështjet rezultojnë si më poshtë:

- Në tabelën nr. 2 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile pa palë kundërshtare*”, rezultojnë se janë gjykuar 2 çështje me afat standard, të cilat të dyja janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 8 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*krime*”, rezultojnë se janë gjykuar 63 çështje me afat standard, nga të cilat 2 janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 61 janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 9 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kundërvajtje*”, rezultojnë se janë gjykuar 10 çështje me afat standard, nga të cilat 3 janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 7 janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, rezultojnë se janë gjykuar 4 çështje me afat standard, nga të cilat 2 janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 2 janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 11 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, rezultojnë se janë gjykuar 112 çështje me afat standard, nga të cilat 27 janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 85 janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 12 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe mosdhëniet juridiksionale me jashtë*”, rezultojnë se janë gjykuar 254 çështje me afat standard, nga të cilat 50 janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 204 janë shqyrtuar brenda afatit standard minimal.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja nuk ka dhënë shpjegime për çështje konkrete, por ka sqaruar se arsyet që një numër i vogël i çështjeve nuk ka përfunduar brenda afateve orientuese, lidhet me: procedurat e njoftimit të palëve ndërgjyqëse, për të cilat është hasur vështirësi për shkak të adresave jo të sakta; kërkesat e palëve për shtyrjen e seancave gjyqësore; administrimin e raportit të vlerësimit nga ana e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Fier dhe vlerësimin e sjelljes nga ana e I.E.V.P-së Fier; kushtet e punës në të cilën punojmë, ku për vitin 2019 Gjykata e Fierit ka pasur mungesa gjyqtarësh. Për sa i përket kërkesave të palëve për shtyrjen e seancave gjyqësore, një pjesë e tyre lidhet me të drejtën e të pandehurve/dënuarve për të pasur një mbrojtës, dhe një pjesë me kërkesat e prokurorëve për shkak të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari të ngutshme hetimore apo për shkak të pjesëmarrjes së tyre në seminare trajnuese. Në lidhje me mosparaqitjen e prokurorit në seancë gjyqësore, ku prania e tij është e detyrueshme, bazuar në nenin 348/3 të K.Pr.Penale, gjyqtarja ka sqaruar se ka përmbushur detyrimin ligjor për vënien në dijeni të drejtuesit të

---

<sup>32</sup>Në pikën 5 shkronja “c” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr. 261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj.”

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me qëllim marrjen e masave për mos zvarritjen e procesit gjyqësor, pavarësisht shkakut të parashtruar nga ana e prokurorit. Në vijim gjyqtarja ka parashtruar se për sa i përket paraqitjes së raportit të vlerësimit nga ana e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Fier dhe nga ana e I.E.V.P-së Fier, prej saj janë marrë të gjitha masat për të shmangur zvarritje të tilla duke bërë me dije Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve Tiranë.

*Në tërësi*, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (84 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (445 çështje), rezulton se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal kohor 18.85 % të çështjeve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 4/pikë. Por referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarës. Gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 613 çështje, nga të cilat çështje penale themeli janë gjykuar 208 çështje ( 63 krime; 10 kundërvajtje; 135 pushim çështjeje) pra 2/fishi i treguesit sasior të përcaktuar në Vendimin Nr.261/2 të vitit 2010. Nga ana tjetër gjyqtarja ka gjykuar edhe 5 çështje familjare me palë kundërshtare dhe 400 kërkesa penale të hetimit paraprak, dërgim çështje për gjyq dhe kërkesa në fazën e ekzekutimit.

## **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 18,85 % ;
- b) shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sikurse është ngarkesa e lartë pasi rezulton se gjyqtarja ka përfunduar gjatë gjithë vitit 613 çështje, nga të cilat 208 çështje themeli, që përkon me 2/fishin e standardit orientues sasior;
- c) ecurisë procedurale të çështjeve, për respektimin e procesit të rregullt ligjor, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 18,85 % të çështjeve jashtë standardit minimal ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (613 çështje të përfunduara me vendim).*

**2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategori, rezulton si më poshtë:

- Në lidhje me çështjet civile të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*” koha mesatare rezulton të jetë 6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.
- Në lidhje me çështje tek kategoria e çështjeve “*penale krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 88.68 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 9 apo 12 muaj.
- Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*penale kundërvajtje*”, koha mesatare rezulton të jetë 153.8 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.
- Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare rezulton të jetë 48,25 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj.
- Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*seanca paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 44.58 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.
- Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 37.45 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.

Duke u bazuar vetëm në analizën matematikore të të dhënave, rezulton se nga 6 kategori çështjesh, për 5 prej tyre (shumicën) koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është me e shkurtër se standardi minimal kohor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka evidentuar se një pjesë e gjyqimeve kanë zgjatur tej afateve të arsyeshme të gjykimit, për shkak të pezullimit të gjykimit sipas përcaktimeve të nenit 352/1 të K.Pr.Penale, siç ka qenë rasti i gjykimit të të pandehurit Edi Shima, me nr. vendimi 202, datë 08.05.2019. Më tej gjyqtarja ka arsyetuar se në zgjatjen e gjykimit ka ndikuar në disa raste dhe pritja e letër porosisë nga autoritetet e huaja, kur është proceduar në këtë formë. Në rastet kur është proceduar me gjykimin e zakonshëm, në zgjatjen e afatit të gjyqimeve ka ndikuar dhe pyetja e dëshmitarëve, për njoftimin e të cilëve është hasur vështirësi për shkak të adresa të pasakta. Gjyqtarja subjekt vlerësimi dhe kryetari i gjykatës, e kanë vlerësuar këtë tregues, në shkallën e aftësisë “shumë të lartë”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit<sup>33</sup>. Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 6 kategori çështjesh, vetëm për njëjërë

---

<sup>33</sup>Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se :“... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.



prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtarja duhej të pikëzohej me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj vetëm për kategorinë e çështjeve “*penale kundërvajtje*”. Duke analizuar këtë kategori çështjesh rezulton se nga 10 çështje, afati standard është tejkalluar në 3 prej tyre, konkretisht çështjet me numër rendor 3, 4 dhe 5 të tabelës me të dhëna statistikore. Sipas shpjegimeve të gjyqtares në Formularin e Integruar rezulton se është specifikuar si një ndër arsytet e tejkalimit të afatit minimal është pezullimi i çështjeve sipas përcaktimeve të nenit 352/1 të K.Pr.Penale, siç ka qenë rasti i gjykimit të të pandehurit Edi Shima, me nr.vendimi 202, datë 08.05.2019 (*çështje e cila gjendet në tabelën 9 të të dhënave statistikore ku pasqyrohen çështjet e kategorisë kundërvajtje penale*).

Në nenin 352 të K.Pr.Penale parashikohet se : “...Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140 -142, të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, gjykata vendos pezullimin e tij dhe urdhëron policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit. **Me kalimin e një viti** nga data e pezullimit të gjykimit për këtë shkak, si dhe në çdo moment kur ka informacione për vendndodhjen e të pandehurit, gjykata rifillon gjykimin, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit. Kur edhe pas kërkimeve të kryera rishtazi i pandehuri nuk gjendet, gjykata deklaron mungesën. Në këtë rast gjykimi zhvillohet në praninë e mbrojtësit.....”

Duke i hequr çështjes së identifikuar nga gjyqtarja periudhën e pezullimit 1 vjeçare sipas përcaktimeve të nenit 352/1 të K.Pr.Penale çështja do të ishte gjykuar për 9 muaj e 11 ditë, jashtë standardit 4 muaj për këtë kategori çështjesh, por nëse do ta llogarisnim me këtë afat çështjen e mësipërme, rezulton se koha mesatare që i dedikohet kësaj kategorie çështjesh do të ishte **110.3 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi 4 muaj për shqyrtimin e çështjeve të kategorisë “*kundërvajtje penale*”.

Sa më sipër vlerësoj se niveli i pikëzimit të gjyqtares për këtë tregues duhet të jetë më i lartë se 4, në nivelin maksimal.

## **KONKLUZIONE:**

Mbështetur në të njëjtën analizë si më sipër rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor për secilën kategori. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

## **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, Në total duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtarja pavarësisht kohës së caktimit të tyre (613)<sup>34</sup> me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda vitit kalendarik (586), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 104.6 %.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin në nivelin “Shumë i lartë”. Kryetari i gjykatës e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në këtë tregues në nivelin “Shumë e lartë”.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 10 pikë.

## **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti rezulton në masën 104.6 %.*

### ***2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar nga nenet respektive të K.Pr.P, është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*” koha mesatare e arsytimit është 2.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*” koha mesatare e arsytimit është 0.4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë “*krime*” koha mesatare e arsytimit është 4.4 ditë, pra dukshëm **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kundërvajtje penale*” koha mesatare e arsytimit është 6.6 ditë, pra dukshëm **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, vleftësim ndalimi si dhe zëvendësim/revokim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 1.6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati

<sup>34</sup> Numri total i çështjeve të përfunduara si relator nga gjyqtarja është 613 dhe jo 614 sa është shënuar në tabelën përmbledhëse.

procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.

- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*rivlerësim mase sigurimi, shuarje mase, përjashtim gjyqtari*), koha mesatare e arsyetimit është 0.7 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm 48 orë i parashikuar nga neni 22/3, 248 /2 dhe neni 261/3 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*caktim mase sigurimi, lejim përgjimi, kontroll banese*), koha mesatare e arsyetimit është 0.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm 24 orë i parashikuar nga nenet 244/1, 222/1 dhe 4 dhe 202/a pika 3 të K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – dërgim në gjyq*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 4.1 ditë, pra **më e shkurtër** afati procedural i posaçëm 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh pg 2 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – kërkesë për pushim procedimi*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 4.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K. Pr. Penale.

## KONKLUZIONE:

*Për sa më sipër*, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të katër kategoritë e çështjeve rezulton më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke treguar shkallë të lartë të aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.*

### 2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

*2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, numri i seancave gjyqësore është plotësuar në tabelat me të dhëna statistikore për çdo çështje dhe numri mesatar i tyre për kategori<sup>35</sup>, rezulton si më poshtë:

- (i) Për kategorinë “penale krime”, numri mesatar i seancave gjyqësore është 12.5;
- (ii) Për kategorinë “seancë paraprake”, numri mesatar i seancave gjyqësore është 2;

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- (i) Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333 i K.Pr.P për çështjet e themelit si dhe brenda afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 332/1 i K.Pr.P për çështjet e që i përkasin kategorisë së seancës paraprake;
- (ii) Seanca e parë gjyqësore është caktuar në çdo rast duke respektuar parashikimet dhe afatet procedurale të parashikuara nga neni 333 dhe 332 të K.Pr.P;
- (iii) Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.
- (iv) Në rastet e mosparaqitjes së dëshmitarëve gjyqtarja ka urdhëruar shoqërimin e tyre nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore.
- (v) Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimit njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurve, njoftimi për të marrë pjesë i prokurorit, i viktimës, për ti dhënë mundësi IEVP-së Fier për paraqitjen e akteve në dobi të gjykimit, për mosformim të trupit gjykues, për mosparaqitje të gjyqtarës për shkak të marrjes së lejes apo për shkaqe shëndetësore, paraqitjen e konkluzioneve me shkrim të palëve etj. Në një rast<sup>36</sup> rezulton se gjykata vendimin e ndërmjetëm për shtyrjen e seancës e ka shoqëruar dhe me paralajmërimin për mbrojtësin për të mos u bërë shkak për zvarritjen e gjykimit pasi në të kundërt do të procedohet me sanksione ligjore. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P. Vetëm në një rast seanca vijuese është caktuar tej këtij afati (1 muaj e 27 ditë) për shkak të pushimeve vjetore në muajin gusht<sup>37</sup>.

Gjyqtarja, në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se planifikimi i seancave gjyqësore për çdo çështje është bërë në përputhje me kompleksitetin e çështjes, numrin e palëve të përfshira në gjykim, dhe në mënyrë të veçantë është mbajtur në

---

<sup>35</sup>Sipas Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), **duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse**”.

<sup>36</sup>Shih seancën gjyqësore të datës 13.03.2019 të dosjes 5 të përzgjedhur me short.

<sup>37</sup>Çështja me nr. 746 regj, datë regjistrimi 04.07.2019 përfunduar me vendimin nr.738, datë 11.09.2019.

konsideratë, respektimi i afatit 15 ditor për ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor dhe përfundimi i gjykimit brenda afateve ligjore procedurale dhe atyre orientuese të miratuara.

Kryetari i gjykatës e ka vlerësuar gjyqtaren me aftësi shumë të larta duke parashtruar se referuar të dhënave statistikore të gjyqtarës, planifikimi i seancave gjyqësore është bërë duke respektuar afatet ligjore.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit<sup>38</sup> parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 në total për çështjet me palë kundërshtarë, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive dhe përfundimin e gjykimit brenda afateve orientuese.

## KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 për një nga kategoritë e çështjeve (*penale themeli*), shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi edhe pse numri mesatar i seancave gjyqësore për njëën nga kategoritë është më i lartë se 3, gjyqtarja ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe ka marrë çdo masë për të siguruar zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të gjykimit në dosjet e vëzhguara. Zhvillimi i më shumë se 3 seancave gjyqësore nuk ka ardhur për shkak që janë përgjegjësi e gjyqtarës, por për shkak të ecurisë procedurale të një prej çështjeve të përzgjedhura me short.

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore ose seancës paraprake, në çdo rast 0 deri 2 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke respektuar afatin procedural 10/ditor të parashikuar nga neni 333/1 dhe afatin 5/ditor të

<sup>38</sup>Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se :”Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore jo-produktive duke kryer me efikasitet veprime të tilla si:

- mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit;
- marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse;
- planifikimi i seancave, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjes, afatet ligjore, dhe mendimin e palëve;
- si edhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave jo-produktive.”

përcaktuar në nenin 332/1 të K.Pr.P. Në një çështje është evidentuar se çështja është regjistruar në datë 12.10.2018 dhe me shortin e datës 15.10.2018 çështja i është caktuar gjyqtarit Roland Jaupaj, i cili në datë 16.10.2018 ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes penale, kërkesë që është pranuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit Vlorë. Në biletën e shortit rezulton se në datën **15.10.2018** (*objektivisht e pamundur që ti ketë kaluar në këtë datë, pasi në këtë datë i ka kaluar gjyqtarit Roland Jaupaj, i cili më pas ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes*), çështja i ka kaluar gjyqtarës {...}, por ndërkohë rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka bërë shënimin se dosja është marrë në dorëzim në datë **30.10.2018**. Gjykata **menjëherë** me marrjen e dosjes në datë 30.10.2018 e ka vënë dosjen në lëvizje duke caktuar seancën gjyqësore në datë 13.11.2018 ora 12.00 si dhe ka marrë masat përkatëse për njoftimin e palëve.

Seancat gjyqësore në dosjet që i përkasin çështjeve penale të themelit dhe atyre të seancës paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P dhe vetëm 1 seancë rezulton të jenë planifikuar jashtë këtij afati për shkak të lejes vjetore të gjykatës në muajin gusht<sup>39</sup>.

Seancat gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e çështjeve penale kanë ndjekur në çdo rast ecurinë procedurale sipas parashikimeve të nenit 355 e vijues, 403, 405 të K.Pr.P në rastet e procedimit me gjykim të zakonshëm apo gjykim të shkurtuar<sup>40</sup> ose 332/b dhe 332/c të K.Pr.P, në rastin e seancës paraprake.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për legjitimin e mbrojtësve, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, lejimin dhe administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, shoqërimin e dëshmitareve, paralajmërimin e avokatit se nëse do të bëhet pengesë në seancën vijuese do të penalizohet me sanksione ligjore etj. Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme me disa minuta, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën, i cili përgjithësisht lidhet me tej zgjatjen e seancave paraardhëse. Seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio (*me përjashtim të seancës së datës 17.01.2019 të çështjes së 5 të përzgjedhur me short, me nr. 561/145 regj.them., datë 12.10.2018, e përfunduar me vendimi n nr.4138(286), datë*

<sup>39</sup>Shih seancën gjyqësore të datës 13.03.2019 të dosjes 5 të përzgjedhur me short, çështja me nr.561/145 regj.them., datë 12.10.2018, e përfunduar me vendimi n nr.4138(286), datë 24.07.2019.

<sup>40</sup>Çështja me nr. 409 regj, datë regjistrimi 15.07.2019, përfunduar me vendimin nr.5154 (351), datë 16.10.2019 është shqyrtuar nëpërmjet procedurës me gjykim të shkurtuar, ndërsa çështja me nr.561/145 regj., datë 12.10.2018, e përfunduar me vendimin nr.4138(286), datë 24.07.2019 është shqyrtuar nëpërmjet procedurës me gjykim të zakonshëm.

24.07.2019) duke u pasqyruar ecuria procedurale e tyre edhe në ekstraktin me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

## **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

### **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

#### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori, në disa raste ndërthurur dhe me veprimet procedurale të gjyqtares.

Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

## **KONKLUSIONE:**

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara, të renditura në mënyrë logjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhje e tyre duke krijuar mundësi për tu shfrytëzuar me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 5 pikë.*

#### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të hartuara nga gjykata (njoftimet, shkresat, procesverbalet,

vendimi gjyqësor), si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesa objekt gjykimi, provat e administruara, kërkesat me shkrim të palëve, diskutimet përfundimtare të tyre).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A Etika në punë**

##### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarës, sipas informacionit të përcjellë nga ILD me shkresën nr. 1796/1 prot, datë 17.08.2020, nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar veten në nivelin maksimal për këtë tregues duke parashtruar se, gjatë gjithë veprimtarisë së saj si gjyqtare, është munduar të jetë korrekte dhe objektive në ushtrimin e detyrës, duke shmangur çdo sjellje që tregon



mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive.

Kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues e ka vlerësuar gjyqtaren me nivel shumë të lartë etik duke parashtruar se gjatë veprimtarisë së gjyqtares në ushtrimin e funksionit të saj ka demonstruar një shkallë shumë të lartë angazhimi dhe përgjegjshmërie. Gjatë ushtrimit të funksionit të ajo ka pasur një sjellje korrekte dhe etike me palët në proces.

## **KONKLUZIONE:**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës, angazhimin apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë dhe duket të pikëzohet më pikët maksimale.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B Integriteti i gjyqtarit**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton se për gjyqtaren {...} nuk është regjistruar asnjë ankesë në ILD dhe ndaj saj nuk janë marrë apo zbatuar masa disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 221/23 prot., datë 21.01.2021, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar integritetin e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

## **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C Paanësia e gjyqtarit**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, është paraqitur vetëm një kërkesë për përjashtim, kërkesë e cila është rrëzuar. Gjithashtu rezulton që vetë gjyqtarja ka hequr dorë në 36 çështje, nga të cilat 33 kërkesa janë pranuar dhe 3 kërkesa janë rrëzuar.

Gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj ka parashtruar se gjatë vitit të vlerësimit nuk ka asnjë kërkesë të palëve për përjashtimin e saj. Ajo ka deklaruar se ka paraqitur kërkesa për

dorëheqje në të gjitha rastet që ka pasur papajtueshmëri për shkak të ligjit, pasi ka vlerësuar kërkesat në fazën e hetimeve paraprake apo në seancë paraprake, si dhe në të gjitha ato raste kur pala ka paraqitur serish të njëjtën kërkesë, që e ka paraqitur më parë, për të cilën gjyqtari i caktuar me short, nuk ka konkluduar me vendim përfundimtar.

Kryetari i gjykatës lidhur me këtë tregues, duke përcaktuar të njëjtin nivel vlerësimi, ka shpjeguar se për gjyqtaren gjatë vitit të vlerësimit nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga palët. Gjithashtu edhe numri i kërkesave për dorëheqje të gjyqtares ka qenë i pa konsiderueshëm dhe ato janë paraqitur nga gjyqtarja vetëm kur ka pasur papajtueshmëri në për shkak të ligjit.

Në tërësi, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A Aftësia e komunikimit.**

##### **4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e drejtpërdrejte, e qartë, transparente, e kuptueshëm duke respektuar të drejtat e palëve dhe duke treguar kujdes për të treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rezulton komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në komunikimin shkresor me subjektet palë ose jo në procesin gjyqësor, gjuha e përdorur është korrekte, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarës dhe vlerësimin e kryetarit lidhur me këtë tregues.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

#### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të palëve apo pjesëmarrësve në gjykim.

#### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar**

**4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtarja ka deklaruar dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim dhe ndërveprim shumë të lartë me stafin e gjykatës, dhe ka krijuar një marrëdhënie harmonike dhe bashkëpunuese me ta.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

**4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 9 aktivitete trajnuese, të cilat janë pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në tërësi aktivitete trajnuese në të cilat ajo ka marrë pjesë janë shtrirë në një periudhë kohore prej 16 ditësh.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve*. Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 9 aktivitete trajnuese të shtrira në 16 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës procedurale dhe materiale penale si dhe në fushën e të drejtave të njeriut.

Në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit gjyqtarja {...} ka deklaruar:

“• Kam ndjekur kursin intesiv të nivelit pasuniversitar nga data 08.05.2008 deri në datën 26.06.2008, në profilin “Konsulenca Ligjore për Shoqëritë Tregtare”, me vlerësimin “Shkëlqyer”. Kjo certifikatë është e njohur nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.liçense 2155, datë 21.11.2007.

• Aktivitetet trajnues me teme “Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit e më gjerë”, organizuar nga Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve.

• Kam marrë pjesë dhe kam prezantuar punimin me temë “The Constitutional Guarantee of Civil Procedural Rights”, në Konferencën Akademike Ndërkombëtare, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Sociale dhe Ekonomike(ISES)

• Kam marrë pjesë dhe kam prezantuar punimin me temë “INTELLECTUAL PROPERTY” (Pronësia intelektuale)”, në Konferencën Akademike Ndërkombëtare, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Sociale dhe Ekonomike(ISES). Dokumentacioni në origjinal është dorëzuar për efekt të vlerësimit profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, VETTING.”.

## **KONKLUZIONE**

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 9 aktivitete trajnuese të shtrira në 16 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime është brenda kufijve minimalë dhe maksimale, 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019) duke u pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet angazhimi i gjyqtarës {...} në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit në aktivitete trajnuese. Gjyqtarja ka deklaruar se nuk i është kërkuar kryerja e një detyre të tillë, duke shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e saj, në kryerjen e kësaj detyre. Gjithashtu, ajo ka shpjeguar se, në rastet kur janë paraqitur kandidatët për magjistratë apo studentë të Fakultetit të Drejtësisë ka qenë e hapur për diskutim dhe ka lejuar pjesëmarrjen e tyre në gjykim. Ndërsa, përfshirja e saj si lehtësuese në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera, ka qenë e pamundur për shkak të kushteve të punës, si dhe rrethanave familjare.

Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

#### **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e saj në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues pranë SHM apo aktivitete të organizuara nga institucione/organizata të tjera, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna konkrete për pjesëmarrjen e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Gjyqtarja lidhur më këtë tregues në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit ka sqaruar se në lidhje me pjesëmarrjen dhe prezantimet në konferencat ndërkombëtare ka sqaruar në treguesin IV-C-a “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, sqarime të cilat janë marrë parasysht në vlerësimin e treguesit të mësipërm.

Kryetari i gjykatës nuk ka bërë komente në lidhje me këtë tregues. Sa më sipër nuk rezulton të jenë evidentuar angazhimet konkrete në të cilat gjyqtarja mund të ketë marrë pjesë gjatë periudhës së vlerësimit.

## KONKLUZIONE

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysht që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë nuk rezultojnë të dhëna konkrete, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.*

### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

Evidentohet se gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit ka deklaruar se punimet që janë prezantuar në Konferencën Akademike Ndërkombëtare, të organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Sociale dhe Ekonomike (IISES), janë botuar në revistat e kësaj të fundit.

Në treguesin IV-C-a “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale” gjyqtarja ka sqaruar se ka marrë pjesë dhe ka prezantuar punimin me temë “The Constitutional Guarantee of Civil Procedural Rights”, në Konferencën Akademike Ndërkombëtare, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Sociale dhe Ekonomike (IISES). Gjithashtu ajo ka deklaruar se ka marrë pjesë dhe ka prezantuar punimin me temë “INTELLECTUAL PROPERTY” (Pronësia intelektuale), në Konferencën Akademike Ndërkombëtare, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Sociale dhe Ekonomike (IISES). Dokumentacioni në origjinal është dorëzuar për efekt të vlerësimit profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, VETTING.



Duke iu referuar deklarimeve të gjyqtarës sa më sipër konstatohet se këto punime nuk janë kryer prej saj përgjatë vitit të vlerësimit (01.01.2019-31.12.2019) dhe si të tilla nuk mund të merren në konsideratë për efekt të vlerësimit të këtij treguesi.

## KONKLUZIONE

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me zero pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarës dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

## NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE

### NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

## PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e

gjqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

## SHTOJCA 1

### KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019

#### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë

		përzgjedhura për vlerësim	
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 0-10 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve

	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	104.6%
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 3 seanca dhe shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të</b>	a. Rregullshmëria e	1. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë

<b>administruar dosjen gjyqësore</b>	dokumentacionit të dosjes	përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

<b>Tregues</b>	<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë

		për vlerësim	
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë

		3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shkël</b>

